

20250741570

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR SHUJTË TË SUBVENCIONUAR STUDENTORE

Neni 1

Në Ligjin për Shujtë të Subvencionuar Studentore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 31/2020, 150/2021, 251/2022, 91/2023 dhe 30/2024), në nenin 2 pika 2) ndryshohet si vijon:

“shfrytëzues të shujtës së subvencionuar studentore” janë studentët e rregullt të regjistruar në ciklin e parë, përkatësisht ciklin e dytë të studimeve, si dhe në studimet e integruara në universitetet shtetërore dhe private në Republikën, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 2

Në nenin 9, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Shfrytëzues të shujtës së subvencionuar studentore janë studentë të rregullt të regjistruar në ciklin e parë, përkatësisht ciklin e dytë të studimeve, si dhe në studime të integruara në universitete shtetërore dhe private në Republikën, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të cilët nuk kanë të hyra mujore në çfarë do lloj baze më të mëdha se neto-rroga minimale në Republikën për vitin rrjedhës.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.